



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 129/14 prot.

Tiranë, më 11.10.2024

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për pozicionin e lirë të punës “Solist i Dytë Lirik (Tenor)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Për t'i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t'i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurentëve, TKOBAP-ja nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme.

Audicioni do të zhvillohet në datën 11.10.2024, ora 14:30, në Hollin e Katit të Dytë të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;

6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.
7. Të ketë njohuri të mira gjuhëve të huaja (preferohet anglisht dhe italisht).

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave të noterizuara. Nëse aktualisht jeni në përfundim të studimeve të larta në nivelin Master për kanto, të depozitohet diploma Bachelor dhe lista e notave të noterizuara dhe një vërtetim se jeni në përfundim të studimeve. Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit
6. Libreza e punës e noterizuar ose vërtetim mbi pagesën e kontributeve
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 4.10.2024, me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Solist i Dytë Lirik (Tenor)”.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.

Programi për konkurimin është interpretimi i roleve të plota (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:

Verdi: “La Traviata”

Verdi: “Rigoletto”

Verdi: “Macbeth”

Puccini: “La Boheme”

Puccini: “Madama Butterfly”

Donizetti: “Lucia Di Lammermoor”

Puccini: "Messa Di Gloria"

Mozart: "Messa Di Requiem"

Shënime:

- 1. Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.**
- 2. Nëse aplikantët nuk do të kenë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor do të mundësojë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të dokumentacionit.**
- 3. Pas verifikimit të dokumenteve të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.**

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën e postës elektronike: sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina

